



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 6109 Prot.

Roskovec, më 01.08 2024

VENDIM

NR 42. DATË 31.07. 2024

**“PËR MIRATIMIN E PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË KËSHILLIT
BASHKIAK PËR MUAJIN QERSHOR 2024”**

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, si dhe Rregullores së Funksionimit të Këshillit të Bashkisë Roskovec neni 88, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

- 1- Miratimin e procesverbalit të mbajtur më datë 28.06.2024, në mbledhjen e Këshillit Bashkiak për muajin Qershori 2024.
- 2- Ngarkohet Sekretari i Këshillit me zbatimin e këtij vendimi.
- 3- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. UB77/1 Prot.

Roskovec, më 01.07.2024

Procesverbal Nr.7

-Imbajtur sot, datë 28.06.2024, ora 12⁰⁰, në mbledhjen e Këshillit të Bashkisë, mbledhje e radhës, me rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
2. Informacion mbi Vendimet e Këshillit të mbledhjes së muajit Maj 2024.
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak.
4. Për mbarimin para kohe të mandatit të anëtarit të Këshillit të Bashkisë Roskovec.
5. Për dhënien e Ndihmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për periudhën 1-31 Maj 2024.
6. Për miratimin e raportit vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit të vitit 2023.
7. Për miratim fonde shtesë në buxhetin e Bashkisë Roskovec për vitin 2024.
8. Për miratimin e dokumentit të parë të PBA 2025-2027.
9. Për dhënien e titullit "Qytetar Nderi".
10. Për miratimin e një modeli kostumografie të veshjes popullore së traditës burimore të trevës së Bashkisë Roskovec.
11. Për ndryshimin e emërtimit të disa rrugëve dhe emërtimin e shesheve në Bashkinë Roskovec.
12. Diskutime dhe komente të qytetarëve.

Ora e hapjes së mbledhjes: 12⁰⁵

Këshilltarët prezent: A.Plaka,E.Musko,Rr.Hazizi, F.Hoxha,L.Goga, E.Buzi, E.Kaçeli, N.Zeka,H.Hajdini, E.Toska, E.Xhaxhaj, Dh.Malka,J.Behaj, S.Bibo Qamili, F.Feleqi,Zh.Metushi.

Këshilltarët që mungojnë: E.Çepele,P.Toro,A.Hoxha,V.Çepele,A.Pelo.

Prezent nga bashkia: Nënkyetari M.Goga, Dr.Ekonomisë,Sp/Shërbimit Social,P/Menaxhimit të Pronave,P/Kulturës,Ekspert të jashtëm.Prezent në sallë kemi edhe qytetarë.

Me plotësimin e kuorumi, Kryetari hap mbledhjen. Prezent në fillimin e mbledhjes janë 15 këshilltar. Kryetari –faleminderit këshilltar që jeni bërë pjesë e mbledhjes së sotme,faleminderit

z.Nënkyetar i bashkisë që je bërë pjesë e kësaj mbledhje, faleminderit administratës pjesës së interesuar për vendimet e sotme të Këshillit Bashkiak, shumë faleminderit edhe qytetarëve të cilët kanë kërkuar të ndjekin nga salla këtë mbledhje të Këshillit Bashkiak, e cila njëkohësisht transmetohet live. Do ju lutem qytetarëve të zbatojnë rregullat, rregulloren e Këshillit të Bashkisë Roskovec në lidhje me këtë mbledhje. Siç po ju thoja më përpara nuk lejohet shfaqja e pankartave, nuk lejohet folja pa leje dhe ndërprerja e kësaj mbledhje. Dhurata-mundem një sekond të lutem? Kryetari-jo nuk mundesh, sepse të lutem..Dhurata-një falenderim kisha shkurt. Do të thoja faleminderit ty në radhë të parë që i falenderove këta pjesmarrës që janë sot këtu. Do falenderoj dhe avokatin Altin Goxhaj..Kryetari-të lutem nuk është shou, do e kesh të drejtën tënde ta marrësh fjalën, të lutem mos ma ndërprit fjalën. Dhurata-falenderon edhe banorët që kanë ardhur, që janë jashtë, janë njerëz të nderuar, të respektuar bashkë me avokatin Altin Goxhaj. Kryetari-e nderuar këshilltare, të lutem duhet ta ndërpresim edukatën e ndërprerjes së fjalës së njëri-tjetrit. Për sa kohë kuorumi i nevojshëm për fillimin e kësaj mbledhje është i duhuri, unë mbledhjen e deklarojë të hapur. Fillojmë me miratimin e rendit të ditës. Fredi-cila është arsyja që për të tretën mbledhje radhazi, nuk futet në rendin e ditës diskutimi i raportit të kontrollit të shtetit, pasi bashkia e ka detyrim ligjor, por edhe në bazë të rregullores së Këshillit Bashkiak neni 141 pika 2 e cila thotë :Këshilli Bashkiak në mbledhjen e muajit Qershori pjesë e raportit vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit, shqyrton raportin e auditit të jashtëm, të dërguar nga Kryetarja e bashkisë, dhe masat e marra për rekomandimet e auditit të jashtëm. Si dhe shqyrton raportin e progresit të planit të veprimit dhe zbatimin e rekomandimeve të lëna nga audit i jashtëm. Kryetari-sigurisht ju keni të drejtë në transmetimin tuaj, dua tju njoftojë se nga ana e ekzekutivit pranë sekretariatit të këshillit ka ardhur informacioni i kërkuar nga ju dhe do të futet në rendin e kësaj dite. Fredi-nuk mund të futet sot se nuk ishim pregetitur. Kryetari-diskutimi nuk fillon dhe mbaron sot, për çdo sqarim shtesë, besoj se me ju kam qënë transparent, kam folur,kam kërkuar dhe detaje se për cilat pjesë të kontrollit ishit të interesuar, dhe nuk mi keni dhënë këto detaje. Në mënyrë absolute ky Këshill gjëzon të drejtën që i jep ligji të llogarimarrjes ose dëgjimeve të llogaridhënieve nga administrata, në zbatim të vendimeve që ky Këshill merr dhe njëkohësisht të gjithë vërejtjeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Mbas diskutimeve që do bëjmë në këtë mbledhje sot, për çdo paqartësi dhe çdo pyetje shtesë që do të ketë nga ana juaj, patjetër që do vazhdojë, nuk është i fundit ky diskutim që do bëjmë sot. Fredi-unë nuk jam dakort për ta futur sot në rendin e ditës, sepse unë kam folur edhe me ju personalisht, edhe me znj.sekretare, dhe më ka thënë që duhet të nxjerrësh pika të veçanta për të, por ligji dhe rregullorja e Këshillit nuk e thotë. Ai do të diskutohet i gjithë, sepse me tha sekretarja janë 200 faqe dhe nuk mund të diskutohen të gjitha, duhet të nxjerresh disa pika, por nuk ka pse të nxjerr pika, ai do diskutohet thelbësisht dhe detyrat që ka lënë, unë propozoj për mbledhjen e ardhëshme. Kryetari-patjetër, megjithatë ashtu si ju kemi njojur me gjithë raportin e KLSH-së, është pregetitur nga ana e administratës dhe një përbledhje e rekomandimeve, të cilën në mbarim të kësaj mbledhje mund ta administroni, për të patur mundësi që të përgatiteni për diskutimin e mbledhjes së ardhëshme. Maksi-nga ana e ekzekutivit janë marr të gjitha masat, është plani i veprimit i cili hyn në fuqi që ditën e zbatimit të akt-kontrollit,dhe mbylljet në 30 Qershori 2024. Planin e veprimit e kemi sjellë sot në Këshill, për ta parë nëse doni dhe e diskutojmë. Plani i veprimit ka afat deri në 30 Qershori, do e merrni sot Kryetaret e grupeve ose kush këshilltar të dojë. Kryetari-lexon pikat e rendit të ditës. Sqaron se pikën Nr.4 të rendit të ditës që është mbarimi i mandatit para kohe të anëtarit të këshillit bashkiak, përsa kohë e kemi këshilltaren të pranishme në sallë, do ta kalojmë në fund të kësaj mbledhje.

1.Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.

Kryetari hedh në votim rendin e ditës, sipas renditjes së pikave dhe ndryshimit të bërë si më sipër për pikën Nr.4 të rendit të ditës, dhe miratohet unanimisht me 15 vota pro.

2. Informacion mbi Vendimet e Këshillit të mbledhjes së muajit Maj 2024.

Sekretarja e Këshillit sqaron informacionin në lidhje me vendimet e miratuara mbledhjen e kaluar. Janë miratuar dy vendime, të cilat nuk janë vendime normative dhe nuk dërgohen në Prefekturë për verifikim ligjor. Pas hyrjes në fuqi të këtyre vendimeve, ka nisur dhe zbatimi i tyre.

3..Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak.

Hidhet në votim procesverbalit i mbledhjes së kaluar dhe miratohet unanimisht me 15 vota pro.

4.Për dhënien e Ndihmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për periudhën 1-31 Maj 2024.

Sp.Shërbimit Social Sonila sqaron projektvendimin. Fredi-pse operojmë një muaj me vonesë për ndihmat ekonomike, se ne po miratojmë të Majit, jemi dhe në fund të Qershoret, u vete dy muaj banorëve, pse operohet kështu, kush është arsyja? Sepse ju e kuptioni që dy muaj, janë njerëz për thesin e miellit. Sonila jep sqarime. Fredi-sepse edhe mbledhjet e këshillit lihen në datën 29, vajti dy muaj. Maksi-sa i përket fondit që vjen nga Ministria, nuk vjen për muajin që jemi brenda, por vjen për muajin paraardhës, dhe ne jemi të detyruar të veprojmë kështu. Brenda muajit nuk vjen fondi. Kryetari-referuar rregullores dhe praktikave të mbledhjeve të këshillit, duke pasur parasysh këtë lloj problematike varësie që mund të vij nga qeverisja qëndrore, por dhe nga koha që u duhet specialistëve për të pergatitur materjalet që do kalohen në këshill, e kemi të paraparë në rregullore që mbledhjet e këshillit lihen le të themi në ngjysmën e dytë ose afér fundit të muajit. Ska më pyetje dhe diskutime. Kryetari hedh në votim projektvendimin sipas metarjalit të paraqitur dhe miratohet unanimisht me 15 vota pro. Dhurata-kërkon të marr fjalen. Kryetari-do ju lutesha që kur kërkohet fjala, në bazë të rregullores kërkohet në lidhje me pikën e rendit të ditës që po diskutohet. Dhurata-në shenjë solidariteti për ata banor që po presin jashtë, ne po largohemi nga kjo mbledhje,faleminderit. Kryetari-në qoftë se kjo është mënyra sesi i përfaqësoni ata qytetarët..4 anëtarët e koalicionit Bashkë Fitojmë ngrihen dhe largohen nga mbledhja. Tani në sallë prezent janë 11 anëtarë. Kryetari-përfitoj nga rasti që ti falenderoj edhe një herë qytetarët të cilët ishin të pranishëm deri më tani në këtë mbledhje. Gjithashtu rezervoj të drejtën që duke e ndjekur live, nëse kanë diskutime janë të mirëpritur në seksionin përkatës që ti bashkohen kësaj mbledhje. Kjo është thirrje për qytetarët, jo thjesht për disa njerëz që duan ti përdorin në një formë të caktuar. Qytetarët që janë duke e ndjekur mbledhjen live janë të mirëpritur. Me gjithë largimin në mënyrë demonstrative të përfaqësuesve të opozitës nga kjo sallë, kuorumi i nevojshëm për vazhdimin e mbledhjes qëndron, për këtë arsy ne vazhdojmë detyrimin përballë së cilës na kanë vënë qytetarët, për të bërë vendimmarrjen e duhur për ata deri në fund të kësaj mbledhje. Faleminderit të gjithë këshilltarëve të cilët qëndrojnë në këtë sallë.

5.Për miratimin e raportit vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit të vitit 2023.

Leksi-Drejtor na i shpjego pak me fjalët e tua, sepse është një raport voluminoz, pastaj nëse kemi diçka mund të shprehemi. Floriana Kryetare e Komisionit të Ekonomisë- Komisioni i Ekonomisë ka rënë dakort. Kryetari-përsa kohë ka rënë dakort dhe nuk është i nevojshëm një sqarim më i hollësishëm, atëherë ju ftoj të nderuar këshilltar kush ka pyetje sa i takon raportit vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit të vitit 2023 ? Nuk ka pyetje dhe diskutime nga këshilltarët. Kryetari hedh në votim projekt-vendimin miratimi i raportit vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit të vitit 2023, sipas materjalit të paraqitur, dhe miratohet unanimisht me 11 vota pro.

6.Për miratim fonde shtesë në buxhetin e Bashkisë Roskovec për vitin 2024.

Dr.Ekonomike Selmani sqaron projekt-vendimin. Fondi prej 2 milion 999 mijë lekë që është nga zëri dhurata dhe sponsorizime nga programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim për projektin “Askush të mos ngelet pas” ,është i përcaktuar dhe në relacionin përkatës se ku do përdoret, për çfarë do përdoret, duke bërë në mënyrë analitike të qartë përdorimin e këtij fondi. Ky është buxhet shtesë, është e ardhur që do vij tani sipas kontratës së lidhur. Leksi-meqënëse edhe në Komisionin e Ekonomisë kjo pikë u ezaurua, do të thotë që jemi dakort. Nuk ka pyetje dhe diskutime për këtë pikë. Kryetari hedh në votim projekt-vendimin sipas materjalit të paraqitur dhe miratohet unanimisht me 11 vota pro.

7.Për miratimin e dokumentit të parë të PBA 2025-2027.

Selmani-ky është dokument i rëndësishëm, është projekt dokumenti i parë i PBA-së, i cili është përpiluar nga e gjithë administrata e bashkisë në bazë të udhëzimeve dhe ligjeve përkatëse, dhe të cilin ne e kemi dërguar që në datën 1 Qershor në Ministrinë e Financave. Risi e këtij dokumenti, e këtij relacioni apo dhe tabelave që ju kemi paraqitur, është sepse të gjitha këto sivjet, bëhen nëpërmjet sistemit të menaxhimit financiar vendor, i cili është një sistem në të cilën futen të gjithë ekipet e menaxhimit të programeve por dhe gjithë drejtuesit e programeve, në të cilën përcaktojnë si objektivat, qëllimet dhe produktet që do të lindin nga zbatimi i këtyre objektivave. Çdo gjë në sistem lë gjurmë, dhe çdo ndryshim që do bëhet në të ardhmen sepse puna vazhdon, do të lërë sistemit qëllimet e produktet që do të lindin nga zbatimi i këtyre objektivave. Padyshim që para këtij ne kemi bërë miratimin e raportit të të ardhurave për PBA-në 2025-2027, kemi miratuar tavanet në muajin Mars për këtë PBA, dhe pas punës së bërë prej gati dy muajsh nga administrata e bashkisë, arritëm në dokumentin e parë, do kalojmë në dokumentin e dytë i cili miratohet në mes të muajit Shtator, pastaj do vazhdojmë me miratimin e buxhetit vjetor dhe dokumentit përfundimtar, i cili miratohet deri në datën 25 Dhjetor. Të gjitha tabelat janë standarte të miratuara sipas udhëzimeve dhe ligjeve në fuqi, që i ka dhe sistemi për të cilin fola. Leksi-komisioni u njoh me materjalin, e kaluam në komision këtë dokument, nuk ka ndonjë ndryshim. Në rast se do kishte ndonjë ndryshim do ta relatonim. Nuk ka pyetje dhe diskutime. Hidhet në votim projekt-vendimi i dokumentit të parë të PBA 2025-2027, sipas materjalit të paraqitur, dhe miratohet unanimisht me 11 vota pro.

8.Për dhënien e titullit “Qytetar Nderi”.

Maksi-në kuadër të festës së bashkisë Roskovec të 24 Korrikut, ekzekutivi ka menduar të paraqesi para jush tre projekt-vendime, secili ka rëndësinë e vet, për të berë të mundur që kjo festë të jetë sa më e gjëzueshme për të gjithë qytetarët e bashkisë tonë. Ne kemi menduar që të bëjmë disa vlerësimë të figurave kryesore që kanë punuar, kanë dhënë kontribut në gjithë aktivitetin e bashkisë tonë ndër vite. Ne ju drejtohem me pesë qytetarë, për të cilin keni dhe relacionin përkatës, Thanas Goga, Zylyftar Xhaxho, Kozma Apostoli, Bashkim Çepele, Aleksandër Jorgaqi. Secili nga këta ka dhënë kontribut maksimal në jetën dhe aktivitetin e përgjithshëm të bashkisë tonë, në fushat përkatëse. Ne duam që këta qytetarë, pasi të marrin miratimin tuaj, pasi kemi marr edhe konfirmimet e gjithë komisioneve përkatëse, tu japim titullin në datën 24 në ceremoninë që do organizohet në qendër të qytetit. Njëkohësisht kemi edhe dy projekt-vendime të tjera, përrugët dhe miratimi për dy kostume, një për shok e një për shoqe. Kryetari-të përqëndrohem i në rendin e ditës dhe projekt-vendimin që kemi tanë. Leksi-për pikën që po diskutojmë, fillimisht nuk jam kundër fare, normalisht ti kalojmë sepse janë njerëz që kanë kontribuar për këtë komunitet. Nga ana teknike Zylyftar Xhaxho ka qënë Kryetar i Këshillit të bashkisë në vitet 1996-2000 duhet shkruar, Kozma Apostoli ka qënë ish Kryetar Komiteti dhe për Aleksandër Jorgaqi normalisht ka qënë drejtor i ndërmarrjeve më të mëdha në qytetin tonë, por ne si futbolldashës që jemi na ka mbetur peng që nuk i dha një ndihmesë të madhe ekipit Rrufeja. Megjithatë kjo nuk e bën këtë që ta rrëzojë që ti japim titullin qytetar nderi. Meqë kemi pesë persona që janë meshkuj, duhet të jetë vëmendja edhe tek femrat, se femrat kanë qënë kontribuese të mëdha në qytetin tonë, dhe vëmendje kryesisht duhet ti krijojmë shtresës së mësuesve, të cilët do kërkojnë shumë vëmendje nga komuniteti ynë. Të bëhen edhe ato qytetare nderi sepse e meritojnë, dhe nuk meritojnë nënçmim dhe sharje nëpër facebook, por meritojnë vetëm respekt në detyrën e tyre fisnike, sepse normalisht ne me fëmijët merremi pak, por gjithë ditën merren mësuesët, të cilët kanë edukuar breza të tërë. Prandaj duhet të ketë më shumë vëmendje për të bërë qytetar nderi, të jenë çik dhe të kursyera pjesa e qytetar nderi, se na dalin pastaj si puna e atij ish Presidentit tonë që gjente njerëz dhe fëmijë, u vinte medalje dhe i bënte qytetar nderi. Nuk e di e ka menduar bashkia stendën që të afishohen qytetarët e nderit dhe me jetëshkrimet e tyre, sepse vit pas viti ose kur ka qënë festa e 24 Korrikut janë dhënë qytetar nderi, nuk e di është menduar nga bashkia si vend për afishimin e qytetar nderi ndër vite? Të ekspozohen në një vend të dukshëm që ta shikojnë qytetarët, dhe me jetëshkrimet e tyre. Unë jam pro këtij projekt-vendimi, dhe me gjithë ato që kisha. Kryetari-faleminderit z. Leksi për vërejtjet e tua që i gjej me vend dhe me vlerë. Hidhet në votim projekt-vendimi dhe miratohet unanimisht me 11 vota pro.

9. Për miratimin e një modeli kostumografie të veshjes popullore së traditës burimore të trevës së Bashkisë Roskovec.

Maksi-për këtë është ngritur një komision me specialist të fushës dhe ne kemi Kryetarin e komisionit, i cili do të relatojë para jush. Z. Maksi Zarka sqaron projekt-vendimin. Ekzekutivi ka marr një nismë dhe të paraqesi para jush miratimin dhe procedurat për krijimin e një kostumografie si për burra dhe për gra. Qëllimi është që bashkia Roskovec në trevën e saj të ketë një kostumografi të formatuar, të miratuar, dinjitoze që të përfaqësojë bashkinë në grupet kulturore. Kriteri bazë do të jetë që një kostumografi të pasyrojë vlerat artistike të këtij populli, shijet estetike, të jetë burimor, autokton dhe të dali rrënja historike e këtij populli. Ne kemi menduar që kostumi i mashkullit në qendër të jetë kostumi me fustanellë, si një veshje gjithë shqiptare, e cila është

dinjitoze, ka dhe elementin e saj që është kombëtar. Për këtë jemi nisur nga dëshmitë e antikitetit, në Kurjan ka ekzistuar një gur varri në shekullin e III pas Krishtit, ne kemi dy babë e bir me veshje të ngashme me fustanellë. Pra kemi burimore nga antikiteti, nga mesjeta, kemi dhe nga koha bashkëkohore. Sa i përket elementeve është kësula, është xhamadani, mongoria, brezi, këmisha e brendëshme, fustanella, janë kalctet dhe në fund opingat me atë topin e kuq ose kuq e zi. Ky do jetë në thelb kostumi i burrit. Ornamentet ne jemi mbështetur tek tradita e kësaj zone, i kemi pasqyruar në dokument ku i kemi marr, kemi vizituar edhe Kishën e Kurjanit dhe Kishën e Shën Gjergjit, kemi marr takim me gjithë përfaqësuesit që kanë qënë në festivalin e Gjirokastrës, kemi parë gjithë fotot e Gjirokastrës që kanë qënë nga Kurjani, Marinza, Strumi, kemi marr takim dhe me familje të cilat kanë një farë tradite të spikatur në ruajtjen e traditës së veshjes. Veshja e gruas është bluzja, xhamadani ose jeleku, është brezi, fustani. Do bëjmë një veshje që vajzat dhe djemtë e Roskovecit kur të dalin në skenë, duhet të ndrijnë. Padyshim që gruaja ka edhe çorapet, sandalet ose kepuçët, si dhe stolitë. Kam vënë re që në zonën tonë nuk vënë stoli ose vënë shumë pak. Në fakt stolia ka qënë pjesë e gruas ilire, stolitë janë ato që e zbukurojnë dhe e bëjnë më të këndëshme gruan tonë. Leksi-në emër të grupit të këshilltarëve, ne sjemi as etnograf që të hyjmë në detaje, përderisa ju na i shpjeguat me detaje të hollësishme dhe i jeni ruajtur traditës së trevës tonë, do të thotë që nuk ka gjë për të diskutuar grupi, dhe e kalojmë si projekt-vendim. Elizabeta-në radhë të parë do doja të falenderoja nismën e gjithë bashkisë dhe bashkëpuntorëve përkatës, për gjithë punën hulumtuese që është bërë. Unë e lexova me shumë vëmendje këtë materjal se i përkas dhe fushës së arsimit, veprimtaritë artistike që ne organizojmë në shkolla i kemi pasur në qendër të vëmendjes, por ishte ajo që e thatë edhe ju që duhet një kostum autokton i zonës me elementët përkatës, që vërtet tregojnë domethënien, dhe do ishte një gjë shumë e mirë. Ju falenderoj dhe për elementet e Kishës që janë gjetur, që i keni ndërthurur, mua më pëlqejnë shumë si kostume, qoftë veshja për femra dhe ajo për meshkuj. Maksi Zarka-pjesa e shpinës së jelekut ose mongores së mashkullit ka një dekoracion të marr nga një artefakt në Kishën tuaj të Kurjanit, i cili si artefakt është i rrallë në Ballkan, janë dy në gjithë Shqipërinë, dhe një nga ato e ka kjo zonë. Pra të jeni të sigurt ju dhe çdo këshilltar, kostumet do të kenë dekoracione nga artefakte vendore. Është kostum shumë i rrallë. Elizabeta-ju përgëzoj dhe urime për gjërat e bukura që do shohim në datën 24. Suksese të mëtejshme. Nënkyetari Maksi- është ngritur një grup pune nga Kryetarja e bashkisë, ku kryeson Maksi, nga punonjësja e bibliotekës, njëkohësisht ka punuar dhe për anën figurative Eneida Hoxha Drejtoresha e Urbanistikës, e cila ka dhënë një kontribut maksimal në përgatitjen e gjithë figurës së kostumografisë. Kryetari-faleminderit zoti Maksi Zarka për ekspertizën e detajuar dhe të kënaqshme, entuziasmi në këtë sallë e tregon punën tuaj të mirë, ju falenderoj. Kryetari hedh në votim projekt-vendimin dhe miratohet unanimisht me 11 vota pro.

10. Për ndryshimin e emërtimit të disa rrugëve dhe emërtimin e shesheve në Bashkinë Roskovec.

P/Menaxhimit të Pronave Eldisoni sqaron projekty-vendmin. Siç e dini në bazë të ligjit përvetëqeverisjen vendore dhe ligjit për sistemin e adresave, bashkitë në rang vendi dhe bashkia Roskovec është në proces të vazhdueshëm për emërtimin dhe korigjin e rrugëve. Konkretisht në bashkinë Roskovec janë paraqitur kërkesa dhe propozime për emërtimin e rrugëve në të gjithë territorin e bashkisë. Nga diskutimet e kryera gjatë takimeve publike nga palët e interesuara, u morën në shqyrtim të gjitha propozimet dhe ju paraqesim: në qytetin Roskovec rruga me emërtimin “Kanali” do të ndryshohet me emërtimin rruga “Faslli Dyle”, në fshatin Jagodinë rruga me

emërtimin e përgjithshëm “Braçallarët” do ndryshohet me emërtimin rruga “Braçe Kapo”. Në Njësinë Kuman kemi ndryshimin në rrugën “Kaçeli” në fshatin Marinëz, e cila do marri emërtimin e ri rruga “Nasi Mita”. Gjithashtu duke marr shkas nga zhvillimi urban që ka marr zona e Marinzës përballë shkollës, me investimet e fundit që ka bërë bashkia, është krijuar mundësia e krijimit të sheshit që ndodhet në hyrje të lagjes së Kodrës, dhe nga propozimet e marra paraqesim emërtimin e sheshit “Mihal Posnjari”. Në Njësinë Kurjan, fshati Kurjan do ndryshojmë emërtimin e përgjithshëm rruga “Metohu” do marri emërtimin rruga “Alush Metohu”. Leksi-në materjalin që kemi parë, vë re që tek pjesa e përgjithshme që thatë përshebull rruga “Braçallarët”, rruga “Dyle” kalon në emra të përvçëm. Nuk e lejon ligji që të vazhdojë ajo rrugë ashtu apo bëhet ndryshimi sepse kështu e ka kërkuar komisioni? Eldisoni-ky është emërtim i përgjithshëm, por duke marr parasysh kërkuesat për personat të cilët kanë dhënë kontribut në këtë zonë, i jepet vlerësim duke emëruar rrugën apo sheshin në këtë emër. Më shumë kjo krijon lehtësi në sistemin e adresave dhe dhënia e vlersimeve të figurave të shquara të zonës. Leksi-kemi emërtuar shume emra rrugësh, nuk shikoj në asnjë kënd ose asnjë rrugë që të vendoset një tabelë me mbishkrimin e këtyre rrugëve. Eldisoni-e gjithë kjo kërkon një fond të posaçëm, i cili është goxha i madh për peshën që mban në buxhet, është parashikuar që në buxhetet e ardhëshme të caktohet një fond i posaçëm për blerjen e tabelave dhe emërtimin e rrugëve. Kemi filluar sivjet me këtë proces, janë kryer blerjet e disa tabelave që po vendosen. Leksi- sikur nuk ka sens, na ngjan sikur i kalojmë vit pas viti, dhe nuk i shikojmë me mbishkrimin të përfjetësuara në tabela. Kryetari-do doja ta bëje pak më të qartë përmua ligjërisht këtë diskutimin që filloi z.Nënkyetar i bashkisë Maksi, sa i takon të drejtës së Këshillit për emërtimin e rrugëve. Diskutuam që ne nuk kemi të drejtë të ndryshojmë emrat e rrugëve, kemi të bëjmë këtu vetëm me rrugët të cilat kanë marr një emërtim në bazë të Vendimit të Këshillit Bashkiak, nëse njëra rrugë është emërtuar nga Këshilli i mëparshëm me emrin “Dyle”, ne na lind e drejta që ta ndryshojmë ta bëjmë “Faslli Dyle”? Eldisoni-në rast se ka një emërtim të përgjithshëm. Kryetari-po në qoftë se ka një emërtim të përgjithshëm, është një emërtim i cili nuk është sanksionuar nga një vendim i mëparshëm i këtij Këshilli, këtë doja të ndaja se këtë spo kuptoj, sepse Këshilli mundet të emërtojë me emra të përgjithshëm në mbledhjen e radhës 10 rrugë, ky Këshill rezervon të drejtën tja ndryshojë prapë emërtimet atyre, pasi merr një vendim? Maksi-emërtimi i rrugës nëse është abstrakt si përshebull rruga “Dyle”, dhe nëse në atë rrugë janë mbi 8 familje me të njëtin mbiemër, kemi plotësisht të drejtë ti vëm një emër me konsensus, dhe nuk ka asgjë të keqe, dhe asnjë këshill tjetër nuk e heq dot emrin e rrugës. Kryetari- nëse kjo rrugë e ka marr me vendim të Këshillit Bashkiak emrin “Dyle”, rezervojmë më të drejtën përmata ndryshuar? Maksi-po. Kryetari-pranë bashkisë Roskovec ka ardhur një kërkuesë për emërtimin e gjithë rrugëve të cilat nuk kanë një emërtësë përfundimtare të miratuar në Këshill. Në lidhje me këtë, ditën që ne kemi bërë mbledhjen e Kryesisë së Këshillit, kemi diskutuar mundësinë e propozimeve dhe nga këshilltarët e këtij Këshilli, sa i takon emërtimit të rrugëve që do ti përkasin një vendimmarrje të mëvonëshme të këtij Këshilli. Propozimi do të vij pasi drejtoria e Urbanistikës të ketë përcaktuar se cilat janë, pas bërjes së një inventari e gjithë këtyre rrugëve, atëherë do të mirëpriten propozime dhe nga këshilltarët. Maksi-me një vendim udhëzimi të qeverisë shqiptare dhe Ministrisë së Infrastrukturës, kërkohet që të gjitha rrugët në shkallë vendi të kenë emërtime me qëllim që të futen në sistemin kombëtar të rrugëve. Ne e kemi filluar studimin, nuk ka afat kohor për arsyen të fondeve. Ne e kemi filluar këtë punë ta bëjmë me iniciativën tonë, kemi rrëth 15-20% të rrugëve pa emra konkret, dhe këtë do e paraqesim para jush herë pas here. Në takimin që pati Kryetari me Kryetarët e Grupeve u kërkua që këto propozime të vijnë dhe nga këshilltarët e djathtë

dhe ne ram plotësishët dakort si ekzekutiv, së bashku me Kryetaren e bashkisë dhe Kryetarin e Këshilit, që në mbledhjet e ardhëshme komision i marri propozime edhe të këshilltarëve, kështu që jemi të hapur për të dhënë propozimet përkatëse kudo, jo vetëm në Roskovec, por në çdo lagje dhe fshat të bashkisë. Ska më diskutime. Kryetari-po ju sqaroj edhe një herë që ndryshimi i emërtimit nuk ka të bëj me emërtesa konkrete të marra nga vendime të mëparshme të Këshillit, por është ndryshim nga emra të papërcaktuar në një emër konkret. Hidhet në votim projekt-vendimi sipas materjalit të paraqitur dhe miratohet unanimisht me 11 vota pro.

Kryetari u bën me dije në lidhje me kontrollin e Prefekturës dhe i jep fjalën Sekretares për një prezantim të shkurtër, për vënienë në dijeni këshilltarëve konkluzionet e këtij raporti. Sekretarja sqaron shkurtimisht konkluzionet e kontrollit të Prefekturës. Për periudhen objekt kontrolli nuk ka rekomandime nga Prefektura e Qarkut Fier.

11. Diskutime dhe komente të qytetarëve.

Kryetari-kemi akoma dhe një pikë të rendit të ditës për diskutim dhe në fund për të votuar, do të kërkojë mirkuptimin tuaj që të marrim tanë diskutimet dhe shqetësimet që ju keni, për tu sekretuar dhe protokolluar në këtë mbledhje, para se të kalojmë në pikën e fundit të rendit të ditës e cila është pikërisht pika për mbarimin para kohe të mandatit të anëtarit të Këshillit Bashkiak. Ti japim mundësinë kolegës të jetë deri në fund me ne në këtë mbledhje të fundit. Kryetari- unë bashkë me ju kemi qënë prezent në këtë sallë, kur në praninë tonë drejtuesi i ujësjellës kanalizime Fier ka premtuar dhe ka thënë që është në planin e investimeve ujësjellësi i Njësisë Administrative Kuman për fshatrat Kuman, Vidhisht, Marinëz dhe Luar nuk e di nëse ishte futur pjesërisht për shkak të terrenit. Vet kam besuar që ky do të ishte një projekt që do të merrte jetë, dhe kam mësuar që janë hasur problematika sa i takon gjetjes së burimit të ujit. Do të doja që drejtoria përkatëse e bashkisë Roskovec ti drejtohet me një kërkesë të përsëritur drejtorisë së Ujësjellës-Kanalizime sh.a Fier, në mënyrë që këtij projekti ti jepet jetë. Leksi-kemi shqetësim të disa bizneseve në qytetin e Roskovecit, që punonjësit e AKU-së u kërkojnë atyre analizën e ujit të pijshëm, kur këtë analizë e bën tjetër kush. Maksi- analiza e ujit të pijshëm bëhet për ujësjellësin, se për biznesin bëhet vetëm për ato biznese të cilat kanë puse dhe punojnë me pusin e tyre, jo për ata që janë të lidhur me ujësjellësin, të cilat kanë pika të përcaktuara nga drejtoria përkatëse. Isa Hoxha sqaron se ka pas raste të tillë kur vjen AKU-ja, kërkon analiza që i bëjnë privatish, paguajnë një faturë prej 38 mijë lekë të vjetra për X biznes të caktuar, por jo për të gjithë bizneset në përgjithësi. Leksi- nga kryqezimi tek ish lokali i Gëzim Caushit e deri tek shkallët e shkollës, trotuari duhet riparuar për arsy se si fëmijët që venë në shkollë, dhe prindërit që i shoqërojnë ka patur raste që janë aksidentuar, janë rrëzuar. Mund ta bëjnë shumë thjeshtë me ndërmarrjen përkatëse. Elizabeta-në lidhje me pemët që janë mbjellë në trotuare, të cilat zakonisht janë ullinj dhe është gjë shumë e mirë dhe pozitive, por do të doja nga ana e ndërmarrjes së pastrim-gjelbërimit, ullinjt ti krasisin dhe ti ngrenë sepse nuk kalohet dot fare në trotuar. Madje unë kam folur dhe në telefon para dy javësh, dhe nuk është marr ndonjë masë. Si dhe për pastrimin e rrugicave, sepse është dhe vapë, ka ferra dhe barëra për të pastruar. E dyta kam pasur pyetje dhe nga prindërit për shkollat verore, dua të di çfarë po bëhet, sepse prindërit kanë plotësuar një formular në lidhje me referencat çfarë kanë dëshirë të bëjnë fëmijët gjatë kësaj periudhe, dhe janë në pritje të një përgjigje. Maksi- për pyetjen e parë, ndërmarrja e pastrimit do të marri masat, ndërsa sa i përket shkollës verore është planifikuar që brenda muajit Gusht të janë dy turne me djem dhe vajza të gërshetuara, grupmosha nga klasa e

parë deri tek e nënta. Ermira-kisha një sugjerim në lidhje me heqjen e mbeturinave në koshat e plehrave, pasi duke qënë se është edhe verë përhapet një erë jo e këndëshme në mjedis. Të kihet tepër parasysh dhe të hiqen sa më shpesh që të jetë e mundur, të punohet me më tepër intensitet në pastrimin e tyre gjatë kësaj periudhe, sidomos në qendrat e banuara dhe ato që janë në mes të fshatrave. Mbushen shumë shpejt koshat dhe hiqen shumë vonë. Meqënëse jemi në periudhë vere, do të kërkoja nga administrata e bashkisë që ato merementimet, rregullimet, çfarë janë planifikuar për rregullimin e ambjenteve të shkollave, në mënyrë që Shtatori të na gjejë në kushte bazike apo komode për fillimin e viti të ri arsimor, të ndërmerren gjatë kësaj kohe dhe të mos lihen për në Shtator. Në shkollën e Kurjanit ne kemi shumë problem me tualetet e brendëshme, pasi janë në gjendje jo të mirë. Duke qënë se shkolla është e rikonstruktuar, ka ambient komod por tualetet nuk ishin në planin e rikonstrukzionit të fundit, por po bëjnë disa vite që ato janë bërë, do të thotë që ato kanë nevojë për ti parë grupet, paisjet hidrosanitare, pasi sanitarja e harxhon pjesën më të madhe të kohës duke tharë ujin. Kërkesë edhe palestra ka nevojë për parketin, pasi është në gjendje jo funksionale, si dhe kërkesë të cilën e kam paraqitur disa herë për vendosjen e disa stolave në oborrin e shkollës. Maksi-është kthyer traditë tashmë që gjatë muajve të pushimeve ne bëjmë ato riparime që janë të domosdoshme, jo të të gjitha shkollave. Elizabeta-kjo vlen për të gjitha shkollat. Nazmiu-dihet që problematikat e shkollave janë të njëjta, por edhe ambjenti i jashtëm si vaditja, bari apo probleme të tjera të mirëmbajtjes. Mundësia për shkollat të krijohet përsa i përket edhe një copë zorre, për të vaditur ai roja apo sanitarja kush e ka për detyrë. Problem tjetër filloj fushata e korries-shirjes, ne jemi fshat kodrinor, rrugët janë problematike. Ne gjithmonë e trajtojmë problemin në momentin kur vjen puna për ta bërë, nuk caktohet një fond i parakohshmëm që të bëhen disa pune aty ku është e nevojshme. Te mirëmbajtja e rrugëve, trotuareve, një gjë që e shikoj në Vlosh, me fshesa dy punonjës ndërsa në Ngjeqar nuk ka asnë, pse kjo gjë? Në Ngjeqar është shumë gjendje e vështirë në lidhje me trotuaret dhe ferrat. Kryetari-fjala juaj është sekretuar në procesverbalin e kësaj mbledhje, shpresoj që vërejtjet tuaja me vend të marrin përgjigje dhe zgjidhjen e duhur nga administrata e kësaj bashkie. Në këtë moment vjen këshilltari Zh.Metushi. Prezent janë 12 këshilltarë. Kryetari pyet nëse ka më probleme për tu ngritur? Nuk ka më.

12.Për mbarimin para kohe të mandatit të anëtarit të Këshillit të Bashkisë Roskovec.

Kryetari-falenderojmë kolegen tonë që ka qënë kaq kohë me ne dhe përkrahë nesh në vendimmarje. Sigurisht do doja dhe unë shumë ta dëgjonim, pasi ligjërisht është hera e fundit që e dëgjojmë si kolege, nëse ky Këshill do të marri vendimin që mandati juaj të ndërpritet. Esmeralda-dua tju falenderoj të gjithëve, keni qënë shumë mbështetës, kjo ishte diçka e re për mua, jeni njerëz fantastik dhe profesionistë shumë të mirë. Ka qënë nder që kam qënë bashkë me ju në këtë periudhë, por që për arsyе personale unë kam vendosur të jap dorëheqjen. Kjo është një punë që do angazhim dhe mendoj që dikush që ka kohën e duhur, do ta bëj atë më mirë sesa unë. Për këtë arsyе jap dorëheqje. Maksi- në kuadër të dy funksioneve si Nënkyetar bashkie dhe Kryetar partie, dua të falenderoj shumë për kontributin e dhënë në fushatë dhe pjesmarrjen në listën e votimit të Partisë Socialiste si këshilltare, për kontributin e dhënë në 1 vit e pak në Këshillin Bashkiak. Unë jam i bindur që kontributi juaj nuk do të mbyllët sot, por përkundrazi me atë nivel inteligjencë që keni arsimor, dhe shërbimit që i jepni qytetarëve në profesionin tuaj të nderuar si mjeke, besoj se do të jeni përsëri pjesë për të dhënë kontributin jo vetëm në Këshill, por edhe në të gjithë

komunitetin, për të qënë ajo që ne kemi njojur, një njeri me vlera maksimale. Kryetari-sqaron projekt-vendimin e mbarimit para kohe të mandatit të anëtares znj. Esmeralda Musko. Në respekt dhe në zbatim të rregullores së këtij Këshilli, këshilltarja që ka paraqitur dorëheqjen nuk është pjesë e votimit të kësaj vendimmarrje. Është mbledhur dhe Komisioni i Mandateve, i jep fjalën Kryetares së Komisionit znj. Ermira Buzi. Ermira-lexon raportin e komisionit, i firmosur nga anëtarët E.Buzi, H.Hajdini, dhe në mungesë anëtarë A.Pelo. Komisioni i Mandateve i propozon Këshillit mbarimin para kohe të mandatit të anëtares znj. Esmeralda Musko, pasi ka dhënë dorëheqje me vullnetin e saj të lirë. Hidhet në votim propozimi i Komisionit të Mandateve si më sipër, dhe miratohet unanimisht me 11 vota pro. Esmeralda Musko nuk mori pjesë në votim. Kryetari-edhe një herë i uroj suksese në fushën profesionale koleges, ka qënë kënaqësi shumë e madhe në këtë kohë bashkëpunimi që kemi pasur, bashkëpunim i cili besoj se do të ngelet gjithë jetën. Duke ju falenderuar të gjithëve ju këshilltar, të cilët në zbatim të vullnetit të atyre zgjedhësve që na kanë besuar, qëndruat me durim për ti shqyrtauar dhe miratuar të gjitha këto projekt-vendime të rëndësishme për qytetarët e bashkisë Roskovec. Kryetari mbyll mbledhjen.

Sekretar

Arlinda Hajdini



Kryetar
Afrim Plaka

